



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 15.03.2023

Nr: 25

Ora: 15:30

VENDIM

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 33 TË PARTISË
DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 15.03.2023, me pjesëmarrjen e:

Ledio BRAHO	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Sali Berisha

OBJEKT:

1. Kundërshtimi i vendimit nr. 172, datë 14.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës së ‘Partia Demokratike’ për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisë vendore të datës 14.05.2023”.
2. Ndryshimi i vendimit duke vendosur, regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë të përfaqësuar nga kryetari Sali Berisha, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZË LIGJORE:

Nenet 21, 123/1, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 10, dhe 17 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Partia Demokratike e Shqipërisë ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore të nënshkruar nga z. Sali Berisha, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 33 regj., datë 15.03.2023. Në mbledhjen e datës 15.03.2023, ora 15:30, pas relatimit të z. Ledio Braho u konstatua se kërkesa ankimore nr. 33 i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

Më konkretisht, në lidhje me kompetencën e KAS për shqyrtimin e kësaj kërkesë ankimore, i referohemi nenit 21 pika 1 shkronja “b” të K.Zgjedhor që parashikon se “1. Në përputhje me dispozitat e këtij ligji, KAS-i ushtron këto kompetenca: ... b) shqyrton dhe zgjidh në rrugë administrative ankesat ndaj akteve të Komisionerit”. Në lidhje me legjitimitimin e ankuesit, neni 123/1 i K.Zgjedhor, në pikë 1 të tij parashikon se “1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së”, ndërkohë që neni 124 i po këtij kodi, në pikën 2 të tij parashikon se “2. Kundër akteve të Komisionerit lejohet ankim në rrugë administrative në KAS nga palët që demonstrojnë një interes të ligjshëm për çështjen objekt i ankimit” dhe për aq kohë sa kjo palë ka qenë pjesë e procedurës administrative të zhvilluar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, procedurë që është mbyllur me vendimmarrjen e këtij të fundit, që është dhe objekt ankimi, atëherë jemi në kushtet që pala

ankimuese legjitimohet për shkak të interesit të ligjshëm që ka në shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore me nr. 33, datë 15.03.2023. Sa i përket elementit të tretë të parashikuar nga neni 130 i K.Zgjedhor, atij që ka të bëjë me respektimin e afateve ligjore për ankimin, neni 124/1 pika 2 i K.Zgjedhor, në fjalinë e tij të dytë, parashikon se *“Në periudhën nga dalja e dekretit të Presidentit të Republikës për zhvillimin e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar, ankimi paraqitet brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit”*. Duke qenë se vendimi objekt ankimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është i datës 14.03.2023 dhe ankimi në lidhje me këtë vendim është depozituar pranë KQZ në datë 15.03.2023, pra brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit, atëherë për KAS edhe ky element që i përket objektit të verifikimit paraprak, konsiderohet i plotësuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, dhe 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 33, datë 15.03.2023, të paraqitur nga Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Sali Berisha.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 16.03.2023, ora 12:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Ky vendimi është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar